



NACIONAL

Gazetë javore, letrare & kulturore

Drejtori: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com

Mob: 068 20 74 316

Gazeta e përditshme online:
www.gazeta-nacional.net

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Gazeta "Nacional" më e kërkuara nga shkrimtarët në Kosovë
Mbresa nga Mitingu i 52-të i Poezisë në Gjakovë, organizuar shkëlqyer nga Klubi Letrar "Gjon Nikollë Kazazi"

Nga **NDUE LLESHAJ**

faqe 3



Poema "Vetëm të vdekurit pendohen" e Skënder Buçpapajt
Një krijim original dhe i pashoq në letërsinë shqipe të pas '90-s

Nga **Illir Nikolla**

faqe 10



EDITORIAL

Kadareja i anatemuar nga Enver Hoxha

NGA URAN BUTKA

Kur lexova shënimet e E. Hoxhës për poezinë "Pashallarët e kuq" në ditarin e tij të fshehtë, u befasova dhe u trondita njëherësh, gjë që s'duhet të më kishte ndodhur. Unë si studiues e njoh mirë figurën e Enver Hoxhës, zbuluar nëpërmes dokumenteve arkivore, e kam të qartë thelbin e mendimit dhe të veprimit kriminal e terrorist të E. Hoxhës, por edhe dyfytyrësinë e tij, hipokrizinë dhe shtirjen për t'u rrëfyer...

Faqe 15



Vehabiststët, grup i një sektit, në shërbim të carizmit rus

Nga **SABRI MAXHUNI (NOVOSELLA)**

Paraqitja e këtij sektit fetar "islamik", që e mori emrin nga themeluesi i këtij sektit Ibn Abdal Vahabi (1703-1792), përputhet me fillimin e fuqizimit të carizmit rus dhe me rënien e Perandorisë Osmane. Vehabistët, të cilët e quanin dhe e quajnë veten të vetmit myslimanë të vërtetë, u përcaktuan për ta luftuar...

Faqe 20



POETI DHE PËRKTHYESI NDREK GJINI RRËFEN NGA IRALANDA BASHKËPUNIMIN ME GAZETËN "NACIONAL"

Ju tregoj si ia dhuruam Presidentit Irlandez, gazetën 'Nacional' ku ishin botuar poezitë e tij

Faqe 4



Anxhela DASHI
Shpallet Miss Grand Kosova



Esterina XHAURI
Shpallet Miss Grand Albania

Dokumente për PKSh nga Arkivi i Shtetit Italian, 1932

Përgatiti: **BEJTULLAH DESTANI**

Aleksandër Tomson, dokumente për Shqipërinë nga 1860 deri 1894

Nga Dr. **FATMIR TERZIU**

NËBRENDËSI

FAQE 6
Agim Bajrami, poeti, midis qiellit dhe tokës
Nga **BASHKIM HOXHA**



FAQE 22
Lulëzim Qose Këngëtar i muzikës buron nga shpirti



FAQE 17
Poezitë e Skënder Kodrës, lëndë e shpirtit të tij
Nga **ISTREF HAXHILLARI**



FAQE 2
Flora Gjondedaj: Shkrimtaria tek ne po bëhet një garnajë gjithëpërfshirëse



FAQE 4-18
Prozë nga:
Gani Mehmetaj • Ilir Paja Bedri Shyti • Bashkim Kadiu Lorenc Blllok • Edona Paloka

FAQE 5-19
Poezi nga:
Mimoza Rexhvelaj • Nazmi Hajdini Jaho Margjeka • Dashamir Malo Mexhid Mehmeti • Stavri Afezulli

Green Go Garden
Faqe 23



LEA CATERING
Faqe 23



<http://amedeobaci.al/>
Kolona e librave autobiografike me perjetime nga historia personale e autorit.
The best Albanian romantic books



aiba COMPANY




Poeti dhe përkthyesi Ndrek Gjini rrëfen nga Iralanda bashkëpunimin me gazetën “Nacional”

Ju tregoj si ia dhuruam Presidentit Irlandez, gazetën “Nacional” ku ishin botuar poezitë e tij

Qe fat që unë u njoha me z. Mal Berisha, qe fat që ai më tregoi se do të vinte në Irlandë për të paraqitur letrat kredenciale të Presidentit Higgins, qe fat që më pyeti se çfarë dhurate mund t'i sillte ai Presidentit. Unë i fola gjatë rreth karrierës së Presidentit Higgins. Ndër të tjera i thashë që ai është edhe poet dhe ka botuar katër libra me poezi. I tregova se unë i kisha përkthyer disa poezi të tijat dhe miku im i mirë Mujo Buçpapaj i ka botuar në gazetën “Nacional”. Ia dërgova faqet e gazetës ku ishin botuar këto poezi dhe kurrë nuk mendoja se ambasador Berisha do i bënte ato në formën e një libërthi të vogël dhe do ia jepte si dhuratë Presidentit të Irlandës. Kjo është vepër e ambasador Berishës. Përkthimi është punë e imja, botimi është mirënjohje dhe vlerësim që më kishte bërë Mujo Buçpapaj. Pra puna krejt rastësisht solli këtë fat.”

Ndrek Gjini, gazetar, poet dhe përkthyes, prej vitit 2002 jeton në Irlandë së bashku me gruan dhe femijët. Pas shumë përpjekjesh ai arriti jo vetëm, të mbijetojë në një botë të veshitur si emigrant, por edhe t'i imponohet ambientit letrar duke u bërë edhe një ndërmjetës i kulturës shqiptare atje.

Ndrek si një mik i imi i hershëm, si kolegë për shumë vjet në gazetën “Rilindja Demokratike,” ka sjellë here pas here përkthime për gazetën letrare dhe kulturore “Nacional.”

Një ditë më thotë se kishte përkthyer poezi nga Presidenti i Irlandës Higgins dhe dëshironte t'i botonte tek “Nacionali.” M'u duk diçka interesante dhe iu luta të m'i dërgonte menjëherë.

Cikli i poezive do të botohej bashke me një CV të presidentit irlandez shoqëruar me një foto të tij, duke siguruar kështu një bashkëpunim mjaft interesant.

Si ka shkuar jehona e këtij cikli në Irlandë



dhe posacërisht si e ka pritur Presidenti irlandez përkthimin dhe botimin në gjuhën shqipe në Nacional, poeti, studiuesi dhe përkthyesi Ndrek Gjini e tregon gjatë një intersvite dhenë për të përditshmen “Koha Jonë” në Tiranë, para të ditësh. I pyetur nga gazetari i “KJ” se “çfarë ndjetë kur vjershat e Presidentit irlandez, z. Higgins, të përkthyer nga Ju, në gjuhën shqipe, ranë në duart e tij, Ndrek rrëfen:

“Ky është rasti tipik, ku mund të them se fati ndonjëherë edhe mund të të vijë, por pasi ke punuar fort për të. Kjo për faktin se qe fat që unë u njoha me z. Mal Berisha, qe fat që ai më tregoi se do të vinte në Irlandë për të paraqitur letrat kredenciale të Presidentit Higgins, qe fat që më pyeti se çfarë dhurate mund t'i sillte ai Presidentit. Unë i fola gjatë rreth karrierës së

Presidentit Higgins. Ndër të tjera i thashë që ai është edhe poet dhe ka botuar katër libra me poezi. I tregova se unë i kisha përkthyer disa poezi të tijat dhe miku im i mirë Mujo Buçpapaj i ka botuar në gazetën “Nacional”. Ia dërgova faqet e gazetës ku ishin botuar këto poezi dhe kurrë nuk mendoja se ambasador Berisha do i bënte ato në formën e një libërthi të vogël dhe do ia jepte si dhuratë Presidentit të Irlandës. Kjo është vepër e ambasador Berishës. Përkthimi është punë e imja, botimi është mirënjohje dhe vlerësim që më kishte bërë Mujo Buçpapaj. Pra puna krejt rastësisht solli këtë fat.

Gjithashtu, Ndrek tregon në vijim se “jam në proces të përfundimit të përkthimit të një libri me poezi të Presidentit aktual të Irlandës, Michael D. Higgins, si dhe punoj intensivisht



Presidenti i Irlandës,
Michael D. Higgins

për editimin dhe botimin e antologjive vjetore të “The Galway Review”. Kam pasur fatin t'i prezantoj bordit drejtues të kësaj reviste disa shkrimtarë shqiptarë dhe fatmirësisht shkrimet e disave prej tyre janë miratuar dhe kanë kaluar për botim.”

Legjenda e Bjeshkëve të Nemuna

Tregim nga GANI MEHMETAJ, Prishtinë

Në valën e dëbimeve, kur refugjatët iknin maleve apo fshiheshin shpellave që të mos i rrihte era, shqota e shiu, me kujtohej legjenda për emrin e Bjeshkëve të Nemuna. Legjenda thotë se një nënë me dy fëmijë, (burrin ia vranë ushtarët turq), mori ikën drejtë Bjeshkëve të Nalta sipëri Rrafshit të Dukagjinit. Me fëmijë për dore nuk u kujtua për sende të tjera, koha nuk priste, ushtarët e armikut mund t'i kapnin. E frikësuar nga ndjekësit, e pikëlluar për vrasjen e burrit, kthente kokën prapa gruaja me dy jetimë nga katundi, ku shquhej shtëpia e saj që i dilte flaka. Një pikëllim i pakufishëm ia mbuloi fytyrën, ia nxii sytë. Ecë e ecë e ujë askund. Sa më shumë që ecte, bjeshkët lartësosheshin, sa më shumë përpiquej t'i shmangej diellit, masa e zjarrtë bëhej më e pamëshirshme, skuqte e digjte si saç. Dhe ata ecnin e ecnin, sa më larg ushtarëve turq.

Dielli i korrikut vazhdonte t'i përvëlonte, etja i kishte molisur nënë e fëmijë. Vijat e ujit në këtë kohë, në të dy krahët sipëri burimit të Drinit shterojnë, bora që dikur rrinte deri në fund të gushtit, për dreq, atë ditë korriku kur u duhej kalamajve të nënës së ve, kishte shkrire në luginat më të fshehura nga dielli përvëlues.

“Nanë, du ujë”, kërkonte më ngulmë djali i vogël, sepse urinë e harruan nga vapa e madhe

e lodhja edhe më e madhe. Po ujë s'kishte askund. “Nanë, t'lutem ni pikë uj”, e përgjeronte vogëlushi, pa e kuptuar se kjo gjë nuk ishte në vullnetin e nënës së gjorë. S'gjendej askund pikë uji sa t'ua njomte buzët e përthara. Nëna e hutuar përpiquej ta ngushëllonte të voglin më fjalë, i madhi nuk bëzante, megjithëse shkruambi i buzëve iu bë një pëllëmbë mbi buzë, thotë legjenda.

“Tash e gjajmë ujit, drita e syve të mi, edhe pak. Gurrat e Bardha nuk janë larg”, përpiquej t'i jepen zemër nëna e shkruambuar nga vapa e pikëllimi. Kaluan Gurrat e Bardha, por uji nuk rridhte as për ilaçe, u ngjiten Malit të Thatë, vija uji askund. Kopetë e deleve me barinj si t'i kishte lëshuar toka a ngrënë ujku, kambana nuk jehonte në tërë Bjeshkët e Nalta, sikurse quheshin dikur. Njëri të gjallë mbi faqe të dheut.

Fëmijët u lodhën, buzët iu bënë shkruambi, forcat u shteruan, nuk mund të flisnin nga etja e nga lodhja, nisën të përpëliten, flisnin përçart. Nënë e mbërtheu kulmi i dëshpërimit. Lotët nuk i rridhnin që t'ua njomte buzët, shihte e dëshpëruar se si kalamajtë po i shuheshin para syve. Por më parë se ti kapte fëmijët agonia,



para se t'ua bënte gjamën, ajo mallkoi në kulm të zemërimit: « Hej, moj bjeshkë, kurrë mos paçi ujë! Flaka u daltë! U shitoftë reja!». Dhe ra shakull në tokë mbi kalamajtë që po i kalonin çastet e fundit të agonisë. Legjenda nuk e thotë ç'u bë më nënën e dy fëmijët. Nuk e thotë as a vdiqën apo i shpëtoi mrekullia, por legjenda vazhdon sikur qielli u mëshirua me fatkeqit që përpëliteshin në agoni, dielli u fsheh prapa reve që nisën të qanin më ngashërim, duke ua lëshuar një shi të rrëmbyeshëm që vërshoi bjeshkë e vrrë.

Të tjerët prapë duke iu referuar legjendës thonë se mallkimi i nënës i zuri të gjitha bjeshkët sipëri Dukagjinit, në të dy anët e Drinit të Bardhë. Nama e nënës u rri edhe sot kërcënueshëm. Bjeshkët e Nemuna u dogjën nga zjarri i mallkimit, reja shkrepin ndonjëherë në qiell të kthjellët duke djegur pyje të tëra. Gur mbi gur nuk mbetën, thotë legjenda. Të mbërthen angështia kur i shikon mijëra hektarë të djegur, brinjë të bjeshkës që dalin në sipërfaqe, gerxha që shkëlqejnë në diell. Mallkimi i ndjek këto bjeshkë edhe sot: zjarret përsëriten çdo vjet, në të njëjtën kohë, në të njëjtin rrugëtim të

nënës: sa herë nisin të këndellen bimësia e filizat e hollë, bie një rrufe dhe i djegë filizat e bredhëve e të çetinave.

Nuk e di fundin e nënës më fëmijë, legjenda nuk e thotë shpëtuan apo vdiqën. Ata morën rrugën e përjetësisë, por sigurisht si fëmijë nuk ma thanë fundin tragjik, sepse përrallat e legjendat gjithëherë përfundonin fatlumësisht.

Megjithatë në Bjeshkët e Nemuna, më thoshte gjyshja, është një mura, shkëmb i skalitur, ku shihet nëna me dy kalamajtë, më bohçe e më matare uji. Barinjët kur kalojnë pranë shkëmbit, e derdhin një curril uji, që t'ua njomin buzët nënës e fëmijëve.

Një motërzim serb shumë më i vonshëm, ka një legjendë tjetër për mallkimin e Bjeshkëve të Nemuna. Sipas kësaj legjende kur ushtria serbe, pasi pësoi disfatë nga malësorët e Rugovës e burrave të Dukagjinit, të të ngjitur vjeshkëve, dielli i pamëshirshëm i dërmoi përfundimisht. Gushti më vapë, ushtria e shkalafitur serbe, që i kishte zënë gjaku i të pafajshmeve, ranë shakull në gërxhe. Legjenda e tyre, e sajuar nga kronistët ushtarak, thotë se generali i tyre tha: “Qofsh e mallkuar” (prokleta da si). Në gjuhën e tyre “Prokletije”, dmth “Të mallkuarat”.

Në hartat gjeografike mbi pesëdhjetë vjet ishin të shënuara të dy emërtimet.